



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

Nr. 155 Prot

Fushe-Arrez, me 10 / 05 / 2024

VENDIM

Nr. 20 . datë. 28 / 04 / 2024

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Petrit Delia fshati Arst, Njësia Administrative Fierz, banesa e të cilit është djegur nga zjarri i rënë me datë 12.02.2024, nga buxheti i bashkise, programi "Emergjencat Civile".

Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e tij te dates 29.04.2024 ne zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" Ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", Ligjit nr. 8756 datë 23.03.2001 "Për Emergjencat Civile", të ndryshuar, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kreu III¹, si dhe ne Vertetimin e leshuar nga MNZ Fushë-Arrëz me datë 12.02.2024 mbi djegien e banesës së shtetasit **Petrit Delia**, pas diskutimeve :

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Fushë-Arrëz për mbështetjen financiare të shtetasit **Petrit Delia** për djegien e banesës së tij nga zjarri i rënë me datë **12.02.2024** me vlere demesh te preventivit strukturor ne vleren e **1037684** leke dhe preventivit te mobiljeve ne vlere **205700** leke me vlere totale demi **1243384** leke ku sipas VKM Nr. 329 datë 16.05.2012, pika 3 paragrafi ç, masa e ndihmes financiare të dhënë do te jetë 50% e dëmit të llogaritur dhe konkretisht **621692** leke.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga bashkia Fushë-Arrëz per familjen e demtuara .
3. Ndihma financiare për familjet e shtetasve **Petrit Delia**, te përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 dhe . ligjin Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile"
4. Për shpërblimin e demit të përdoret fondi i Emergjencave Civile i cili sistemohet në Gr.17, Tit 10910, Kap 1, Art 604.0099 ,Kod I Projektit 91707AB ne vleren **621692** leke
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së sipër cituara, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë **12.02.2024**.
6. Ky vendim u shpall me datë 03/05/2024 dhe hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
7. Për zbatimin e këtijë vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

Ky vendim u miratua me 8 vota pro

Vota kundër 0 vota

Vota abstenim 1 vota

Ky vendim u shpall me datën 10 / 05 / 2024

SEKRETARI

Tom CURRI

KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

